

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Oxygen Travel & Multiservices Agency” SH.P.K**

Ortaku themelues:

**Shoqëria “Endless Group” shpk, me numer NIPT M422040320 dhe Numer Serial SERIAL: SN-014843-10-24, me pronesi shiptare, me adrese Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqiperi, e themeluar prane Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 17/09/2024, perfaqesuar nga Zj. Dorina Bala, me numer ID H95926058G, si administrator i shoqerise**

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 31.01.2025, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

***Emri***

- 1.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin **“Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k**
- 1.2. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

Shoqëria tregtare **“Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k** ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k** do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 1 , Rruga Ali Demi , Nr Pasurie 7/15 + 6 - 57/2 , Z.K 8150 , Kati 1 , P 135 1001, Tirane, Shqiperi.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jete:

- Agjensi turistike çdo lloj sherbimi tjeter ne fushen e turizmit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Agjent i shoqerise Easypay Sh.p.k (Institucion i Parase Elektronike) per kryerjen e sherbimeve qe perfshijne por nuk kufizohen ne pagesa faturash & transferta parash, shitje te mallrave/sherbimeve te partnereve te Easypay rimbushje elektronike etj.
- Dhenie makina me qera,
- Siguracione makinash
- Dhenie Apartamente ditore Air b&b,
- Real estate
- Sherbime per transport udhetaresh, agjensi udhetimesh, guida turistike, organizim ekskursionesh, kampe verore per femije dhe per te rritur, aktivitete sociale, kulturore brenda dhe jashte territorit shqiptar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.



- Trajtime profesionale nga fushe objekti i veprimtarise.
- Sherbime konsulence administrative dhe ligjore, etj.
- Sherbime per aplikim per emigracion, per e-Albania, aplikim per viza dhe leje qendrimi.

#### **NENI 5** ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të paçaktuar.

#### **NENI 6** ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit.

#### **NENI 7** ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k

Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në vlerën e aksioneve që ata kanë kontribuar në shoqëri.

#### **NENI 8** ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k është 100.000 (njqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët e shoqërise:

- Shoqëria “Endless Group” shpk, me numer NIPT M422040320 – 1 kuotë – 100% - me vlerë 100.000 (njqind mijë lekë)

#### **NENI 9** ***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

#### **NENI 10** ***Administratori***

10.1. Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

10.3. Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Rudin Tabaku**.



**NENI 11**  
***Sekreti tregtar***

Ortakët, administratorët dhe punëmarrësit e shoqërisë “Oxygen Travel & Multiservices Agency” sh.p.k përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**  
***Mosmarrëveshjet***

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**Shoqëria “Endless Group” shpk, me numer NIPT M422040320**

**Administrator i Shoqërisë**

**Dorina Bala**

**DORINA BALA**  
